



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKT LIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_/2018

**PËR**

**CENSIN E POPULLSISË DHE TË BANESAVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti i ligjit**

Ky ligj rregullon organizimin dhe realizimin e censit të popullsisë dhe të banesave në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 3, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”.

**Neni 2**  
**Qëllimi i censit**

1. Censi synon t’u ofrojë Kuvendit, qeverisë, njësive të vetëqeverisjes vendore, organizatave ekonomike, shkencore e kulturore, si dhe gjithë shoqërisë civile të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit, për analiza private e publike të vendimmarrjes, kërkime shkencore dhe, në përgjithësi, për përmirësimin e njohjes e të kuptuarit nga shtetasit të realitetit demografik, ekonomik dhe shoqëror të vendit.

2. Censi ofron të dhëna për:

- a) numrin dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë vendbanuese;
- b) strukturën demografike dhe karakteristikat kryesore të popullsisë;
- c) numrin, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e banesave e të ndërtesave që përdoren për qëllime banimi;
- ç) kushtet e strehimit të popullsisë.

### **Neni 3 Përkufizime**

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) **“Popullsi”**, popullsia në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, e cila gjendet në vendbanimin e zakonshëm në momentin e censit;
- b) **“Ndërtesë”**, një strukturë e përhershme, që përmban banesa të zakonshme, të projektuara për banim njerëzor ose që janë të rezervuara për banim sezonal, dytësor apo që janë boshe;
- c) **“Banesë”**, një vend i veçantë dhe i pavarur vendbanimi ose i menduar për banim nga njësitë ekonomike familjare, pavarësisht nëse është i zënë ose jo në momentin e censit apo nëse nuk është menduar për banim, por është përdorur si vendbanim në momentin e censit;
- ç) **“Vendbanim i zakonshëm”**, vendi ku personi, zakonisht, kalon periudhën e përditshme të pushimit, pavarësisht nga mungesa të përkohshme për qëllime rekreative, pushime, vizita në miq dhe të afërm, biznes, trajtim mjekësor ose pelegrinazhi fetar.

Personat, që konsiderohen si vendbanues të zakonshëm të një zone gjeografike, janë ata:

- i. që kanë jetuar në vendbanimin e tyre të zakonshëm për një periudhë të vazhdueshme, të paktën 12 muaj përpara datës referuese;
- ii. që kanë ardhur në vendbanimin e tyre të zakonshëm gjatë 12 muajve para datës referuese, me qëllim që të qëndrojnë aty për, të paktën, një vit.

Kur rrethanat e përshkruara në paragrafët “i” ose “ii” nuk munden të përcaktohen, 'vendbanimi i zakonshëm' do të thotë vendi i ligjshëm ose vendbanimi i regjistruar.

- d) **“Njësi ekonomike familjare (NjEF)”**, një person, i cili jeton vetëm, ose një grup personash, të cilët jetojnë bashkë në një pjesë ose në të gjithë banesën dhe ndajnë ushqimin dhe gjëra të tjera të domosdoshme për të jetuar;
- dh) **“Banesa kolektive”**, mjediset që janë të projektuara për banim të përbashkët nga grupe individësh ose disa njësi ekonomike familjare dhe që përdoren si vendbanim i zakonshëm nga, të paktën, një person, në momentin e censit;
- e) **“Cens”**, mbledhja e informacionit me anë të pyetësorëve dhe përpunimi i të dhënave të marra, në mënyrë që të sigurohet numërimi i plotë i të gjithë individëve, njërive ekonomike familjare, banesave dhe ndërtesave të shfrytëzuara për qëllime banimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në një moment të vetëm në kohë, si dhe prodhimi i statistikave në lidhje me karakteristikat demografike, ekonomike e sociale të popullsisë së Shqipërisë;
- ë) **“Dita e censit”**, dita e parë e fillimit të mbledhjes të të dhënave në terren;
- f) **“Momenti i censit”**, ora 00:00 e mesnatës, që paraprin ditën e censit;
- g) **“Mbledhja e të dhënave”**, procesi i mbledhjes së informacionit të censit në një territor të caktuar, për një periudhë të caktuar kohore, nëpërmjet intervistave të kryera nga stafi i terrenit, plotësimit të pyetësorëve për secilën ndërtesë, vendbanim, njësi ekonomike familjare dhe individ në atë territor;
- gj) **“Periudhë e mbledhjes të të dhënave”**, periudha kohore, gjatë së cilës të dhënat mund të mblidhen nga publiku nëpërmjet stafit në terren të censit;
- h) **“INSTAT”**, Instituti i Statistikave të Shqipërisë, që është autoriteti ekzekutiv përgjegjës për planifikimin, zbatimin dhe menaxhimin e censit;
- i) **“Të dhëna personale”**, çdo lloj informacioni i parashikuar në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- j) **“Refuzim”**, mospranimi ose kundërshtimi i personave të përcaktuar në pikën 1, të nenit 5, të këtij ligji, për dhënien e informacionit të kërkuar në pyetësorët e censit.

#### **Neni 4**

#### **Pyetësi i censit**

1. Pyetësi i censit është instrumenti i hartuar nga INSTAT-i dhe i pasqyruar në planin vjetor, sipas nenit 9, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”, i cili përmban pyetjet e detyrueshme dhe kërkesat për mbledhjen e informacionit të nevojshëm për prodhimin e statistikave zyrtare të popullsisë dhe banesave.
2. Pyetësi i censit mund të përmbajë pyetje për grupin etnik, fenë dhe gjuhët, përgjigjet e të cilave bazohen në deklarin e lirë dhe jo të detyrueshëm të individit. Këto pyetje duhet të përmbajnë alternativën e përgjigjes për të intervistuarin “preferoj të mos përgjigjem”.

## **Neni 5**

### **Detyrimi dhe e drejta për t'u përgjigjur**

1. Të gjithë personat madhorë, me shtetësi shqiptare apo të huaj, si dhe personat pa shtetësi, me përjashtim të personelit diplomatik të akredituar në Shqipëri, të cilët në momentin e censit po jetojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të japin informacionin e kërkuar në pyetësorët e censit.
2. Personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, janë të detyruar të japin informacionin e kërkuar:
  - a) në mënyrë të plotë;
  - b) në mënyrë të saktë dhe të besueshme.
3. Për përmbushjen e detyrimit për të dhënë informacionin e kërkuar, personave me aftësi të kufizuar duhet t'u sigurohet aksesin i nevojshëm, sipas llojit të aftësisë së kufizuar.
4. Personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, të kërkuar të japin informacionin e kërkuar në pyetësorin e censit, kanë të drejtën të informohen nga INSTAT-i për:
  - a) qëllimin dhe synimin e censit;
  - b) të drejtat dhe detyrimet që kanë lidhur me dhënien e informacionit të kërkuar;
  - c) pyetjet e detyrueshme për të dhënë informacion dhe pyetjet jo të detyrueshme;
  - ç) masat që merr INSTAT-i për të siguruar konfidencialitetin statistikor.

## **Neni 6**

### **Institucioni i censit**

1. Censi organizohet dhe zbatohet nga Instituti i Statistikave (INSTAT), me mbështetjen e Komisionit Qendror të Censit dhe të zyrave të censit në nivel bashkie. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre organeve përcaktohen në kreun II, të këtij ligji.

2. Komisioni Qendror i Censit dhe zyrat e censit, organizma të ngritur sipas parashikimeve të këtij ligji, kanë funksion mbështetës për INSTAT-in, për të lehtësuar punën në kryerjen e suksesshme të censit, dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre deri në një muaj pas përfundimit të mbledhjes të të dhënave në terren.

### **Neni 7**

#### **Dita e censit dhe periudha e mbledhjes të të dhënave**

Data e ditës së censit dhe periudha e mbledhjes të të dhënave në terren përcaktohen në planin vjetor për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, sipas parashikimit të neneve 9 e 10, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”.

### **Neni 8**

#### **Kategoritë e të dhënave dhe përdorimi i tyre**

1. Të dhënat e mbledhura nga censi kategorizohen në:
  - a) identifikuese dhe personale, të individëve dhe njërive ekonomike familjare;
  - b) identifikuese dhe strukturore, të ndërtesave, banesave, banesave kolektive.
2. Të dhënat e mbledhura nga censi do të përdoren vetëm për qëllime statistikore, në përputhje me ligjin nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”, duke marrë në konsideratë standardet dhe rekomandimet e Eurostat-it dhe të Kombeve të Bashkuara në lidhje me censet.
3. Të dhënat e mbledhura nga censi nuk do të përdoren për asnjë listë elektorale apo përditësimin e ndonjë regjistri civil ose regjistri tjetër administrativ.

### **Neni 9**

#### **Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti**

1. Konfidencialiteti i të dhënave të grumbulluara nga censi është i mbrojtur nga neni 31, i ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”.
2. Çdo person ose autoritet publik, i cili nëpërmjet përfshirjes në proceset e censit merr ose ka dijeni për të dhëna personale, i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit mbi to, sipas përcaktimeve të ligjit nr.17/2018,

“Për statistikat zyrtare”, dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Konsiderohet shkelje e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit, sipas përcaktimit të pikës 2, të këtij neni, kur personi nuk vazhdon të ruajë konfidencialitetin e këtyre të dhënave personale edhe pasi ka ndërprerë përfshirjen në cens.
4. INSTAT-i merr të gjitha masat e duhura teknike, organizative dhe të sigurisë për të parandaluar hyrjen e paautorizuar në instalimet ku të dhënat personale të censit mbahen, përpunohen ose ruhen, dhe për t’i mbrojtur ato nga shkatërrimet e paligjshme, aksidentale, humbjet aksidentale si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.
5. INSTAT-i duhet t’i trajtojë të dhënat e mbledhura, të përpunuara e të ruajtura të censit si rreptësisht konfidenciale kur lejon individët dhe njësitë e tjera statistikore të identifikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.
6. INSTAT-i duhet të marrë masat e duhura për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të censit. Kur përpunimi i të dhënave bëhet nga INSTAT-i, në një mënyrë që përfshin identifikimin e drejtpërdrejtë, këto të dhëna duhet të kodohen.
7. INSTAT-i duhet të ruajë të dhënat e mbledhura të censit në përputhje me nenin 32, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”.

## **Neni 10**

### **Rezultatet e censit**

Rezultatet statistikore të censit janë një pasuri e përbashkët e të gjithë shoqërisë shqiptare dhe shpërndarja e tyre duhet të bëhet në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- a) INSTAT-i paraqet dhe boton rezultatet paraprake dhe ato përfundimtare të censit mbi baza shkencore e profesionale;
- b) Rezultatet statistikore, të përcaktuara në shkronjën “a”, të këtij neni, publikohen në nivel kombëtar, vendor dhe në nivel tjetër gjeografik, duke siguruar që ato të paraqiten në një formë që e përjashton identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të individit apo njësisë ekonomike familjare;

- c) INSTAT-i duhet të publikojë rezultatet e censit vetëm në një formë që pengon identifikimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të individëve dhe njësive të tjera statistikore;
- ç) Për qëllime kërkimore dhe shkencore, e drejta e hyrjes në të dhënat konfidenciale jepet vetëm sipas parashikimeve të pikës 7, të nenit 31, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”.

## **KREU II**

### **PËRBËRJA, PËRGJEGJËSITË DHE MARRËDHËNIET E ORGANEVE TË NGARKUARA PËR TË BËRË CENSIN**

#### **Neni 11**

##### **Përbërja e Komisionit Qendror të Censit**

1. Komisioni Qendror i Censit drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it dhe në përbërjen e tij ka anëtarë:
  - Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
  - Ministrin e Brendshëm;
  - Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;
  - Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
  - Ministrin e Drejtësisë;
  - Ministrin e Mbrojtjes;
  - Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
  - Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
  - Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
  - Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit;
  - Ministrin e Kulturës;
  - Ministrin e Shtetit për Diasporën;
  - Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
  - Drejtorin e Drejtorisë së Statistikave Sociale në INSTAT;
  - Drejtorin e Përgjithshëm të ALUIZN-it;
  - Kryeregjistruesin e Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë;
  - Drejtorin e Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
  - Dekanin e Fakultetit Ekonomik, në Universitetin e Tiranës;
  - Tre specialistë nga bota akademike, respektivisht në fushën e gjeografisë, informatikës dhe demografisë;
  - Drejtorin e Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje në Kryeministri;
  - Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
  - Kryetarin e Komitetit për Pakicat Kombëtare.

2. Përfaqësuesit e botës akademike përzgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga radhët e personelit të brendshëm të trupit akademik të Universitetit të Tiranës dhe caktohen nga rektori i këtij universiteti brenda 5 ditëve, nga paraqitja e kërkesës nga INSTAT-i.

## **Neni 12**

### **Përgjegjësitë e Komisionit Qendror të Censit**

1. Komisioni Qendror i Censit, në vijim “Komisioni”, ngrihet për të mbështetur përgatitjen dhe zbatimin e censit të përgjithshëm të popullsisë dhe banesave.
2. Komisioni Qendror i Censit ka këto përgjegjësi:
  - a) Harton dhe miraton rregulloren e Komisionit Qendror të Censit;
  - b) Ndjek përgatitjen dhe zbatimin e censit dhe mbështet INSTAT-in për të siguruar të dhënat statistikore që priten nga institucionet publike, rrethet shkencore dhe shoqëria civile;
  - c) Lehtëson bashkërendimin e punës ndërmjet ministrive dhe institucioneve qendrore e shkencore për mbështetjen e censit;
  - ç) Miraton kalendarin e veprimtarive për përgatitjen dhe zbatimin e censit, në përputhje me planin vjetor, të parashikuar në nenet 9 e 10, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikat zyrtare”;
  - d) Shqyrton çdo kërkesë të paraqitur në lidhje me miratimin për mbledhjen e informacionit nga publiku gjatë periudhës prej 6 javësh, përpara ditës së censit, dhe gjatë periudhës së mbledhjes të të dhënave të censit, në përputhje me nenin 21, të këtij ligji.

## **Neni 13**

### **Funksionimi i Komisionit Qendror të Censit**

1. Komisioni mblidhet jo më pak se një herë në muaj, deri në përfundimin e kalendarit të veprimtarive për përgatitjen dhe zbatimin e censit. Në mungesë të kryetarit të Komisionit, mbledhja kryesohet nga ministri i Brendshëm.
2. INSTAT-i ngarkohet me detyrën e sekretariatit të Komisionit dhe ka këto detyra:
  - a) Njofton anëtarët e Komisionit për mbledhjen e radhës;
  - b) Mban procesverbalin e mbledhjes;



- c) Përgatit dokumentacionin bazë të mbledhjes, të paktën 5 ditë përpara datës së mbledhjes.
3. Komisioni Qendror i Censit e zhvillon mbledhjen e parë të tij jo më vonë se 4 muaj, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

## **Neni 14**

### **Përgjegjësitë e Institutit të Statistikave**

#### 1. Instituti i Statistikave (INSTAT) ka këto përgjegjësi:

- a) Harton programin e punës, përcakton metodologjinë, përzgjedh e prokuron mjetet teknike dhe programet kompjuterike të përshtatshme, harton pyetësin, nxjerr udhëzimet e nevojshme, përgatit manualin e instruksionit për stafin e terrenit, kryen përgatitjen dhe zbatimin e censit në baza profesionale dhe shkencore;
- b) Menaxhon burimet njerëzore e financiare të ofruara për censin dhe u raporton Komisionit Qendror të Censit dhe donatorëve ndërkombëtarë përdorimin e këtyre burimeve;
- c) Njofton autoritetet dhe organet qeveritare përkatëse për hapat që duhen marrë për censin;
- ç) Udhëzon zyrat e censit në nivel bashkie për detyrat që kanë për mbështetjen e censit;
- d) Cakton personat përfaqësues të INSTAT-it si anëtarë në zyrat e censit në nivel bashkie;
- dh) Zhvillon fushatën e njoftimit publik, në përputhje me nenin 19, të këtij ligji;
- e) Kryen procedurat e përzgjedhjes, të rekrutimit dhe trajnimit të stafit të terrenit me mbështetjen, sipas nevojës, të zyrave të censit në nivel bashkie;
- ë) Menaxhon mbledhjen e të dhënave dhe marrjen e të dhënave të censit nga stafi i terrenit;
- f) Përpunon të dhënat e mbledhura nga censi dhe ndërmerr masat e duhura për mbrojtjen e konfidencialitetit të tyre, në përputhje me parashikimet e nenit 8, të këtij ligji;
- g) Paraqet e publikon të dhënat paraprake dhe përfundimtare, në përputhje me nenin 10, të këtij ligji;
- gj) I raporton Komisionit Qendror të Censit ecurinë e aktiviteteve të censit;
- h) Mbulon detyrën e sekretariatit të Komisionit Qendror të Censit.

2. INSTAT-i mund të ndërmarrë çdo aktivitet tjetër të domosdoshëm për kryerjen e censit, sipas nevojës.

### **Neni 15** **Zyrat e censit**

1. Zyrat e censit ngrihen në çdo bashki, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të ngritura sipas ligjit nr.115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Për njësinë administrative të Tiranës, zyrat e censit ngrihen në çdo njësi bashkiake.

2. Zyra e censit duhet të ndjekë udhëzimet dhe instruksionet e INSTAT-it, t'i japë të dhëna, lehtësira dhe asistencë personelit të censit brenda territorit të bashkisë, si dhe të marrë çdo masë tjetër të nevojshme për të siguruar kryerjen e suksesshme të procesit të mbledhjes të të dhënave të censit brenda territorit përkatës.
3. Zyrat e censit funksionojnë deri një muaj pas përfundimit të procesit të mbledhjes të të dhënave.

### **Neni 16** **Përbërja e zyrës së censit**

1. Zyra e censit drejtohet nga kryetari i bashkisë, ka si zëvendëskryetar përfaqësuesin e zyrës rajonale të INSTAT-it dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- Mbikëqyrësin e censit;
- Përgjegjës in e Zyrës së Gjendjes Civile;
- Drejtuesin e strukturës së shërbimeve sociale në bashki;
- Përgjegjës in e Zyrës së Urbanistikës në bashki;
- Përfaqësuesin e Policisë së Shtetit.

2. Zyra e censit në njësitë bashkiake të Tiranës ka këtë përbërje:

- |                                                             |                  |
|-------------------------------------------------------------|------------------|
| - Administratori i njësisë bashkiake                        | kryetar;         |
| - Përfaqësuesi i INSTAT-it                                  | zëvendëskryetar; |
| - Mbikëqyrësi i censit                                      | anëtar;          |
| - Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile                    | anëtar;          |
| - Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit në territorin përkatës | anëtar.          |

## **Neni 17**

### **Përgjegjësitë e zyrës së censit**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës së censit janë:
  - a) Mbështet INSTAT-in në organizimin dhe drejtimin e punës përgatitore në zonat e numërimit, brenda juridiksionit përkatës të njësisë administrative;
  - b) Ndihmon INSTAT-in në përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve që do të përdoren gjatë fushatës së informimit;
  - c) Vë në dispozicion ambiente të nevojshme për të lehtësuar proceset e trajnimit të stafit të censit dhe koordinimit të punës ndërmjet anketuesve, kontrollorëve, mbikëqyrësve dhe specialistëve IT gjatë periudhës së mbledhjes të të dhënave;
  - ç) I raporton INSTAT-it ecurinë e përmbushjes së detyrave të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni:
    - i. një herë në javë, gjatë fazës përgatitore të testimit;
    - ii. çdo ditë, gjatë periudhës së mbledhjes të të dhënave.

## **Neni 18**

### **Funksionimi i zyrës së censit dhe mbledhjet**

1. Zyra e censit drejtohet nga përfaqësuesi i zyrës rajonale të INSTAT-it:
  - a) në mungesë të kryetarit të zyrës së censit;
  - b) kur, bazuar në raportet periodike, sipas pikës “ç” të nenit 17, të këtij ligji, të paraqitura pranë Komisionit Qendror të Censit, vlerësohet nga ky Komision se nuk janë përmbushur detyrimet nga kryetari i zyrës së censit për të realizuar detyrat e përcaktuara në këtë ligj;
  - c) kur kryetari i bashkisë apo administratori i njësisë bashkiake nuk është i mandatuar në këtë funksion.
2. Në mbledhjen e zyrës së censit duhet të marrin pjesë vetëm anëtarët, me përjashtim të rasteve kur kryetari i zyrës së censit mund të ketë ftuar, sipas çështjeve që diskutohen,:
  - a) specialistët e institucioneve në nivel qarku apo nivel vendor, të cilët nuk përfaqësohen në zyrën e censit;
  - b) ekspertët apo personel tjetër të INSTAT-it, të angazhuar për censin.

3. Mbledhjet e censit zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
4. Takimet duhet të zhvillohen, të paktën, një herë në muaj, me përjashtim të rasteve kur është e nevojshme që zyra e censit të mblidhet më shpesh.
5. Kryetari i zyrës së censit duhet t'u vërë në dispozicion anëtarëve të zyrës së censit dokumentacionin e çështjes që do të shqyrtohet në mbledhjen e zyrës së censit, sipas rendit të ditës.
6. Njoftimi për mbledhjen dhe rendi i ditës, sipas pikës 5, të këtij neni, nënshkruhen nga kryetari i zyrës së censit dhe, në mungesë të tij, nga nënkryetari i saj.
7. Rendi i ditës dhe dokumentacioni i çështjeve për diskutim propozohen nga INSTAT-i.
8. Kryetari dhe, në mungesë të tij, nënkryetari i zyrës së censit, pasi shqyrton propozimin për rend dite dhe dokumentacionin e paraqitur, vendos datën e mbledhjes së zyrës së censit, e cila, në asnjë rast, nuk mund të jetë më vonë se 3 ditë, nga dita e paraqitjes së kërkesës nga INSTAT-i, sipas përcaktimit në pikën 7, të këtij neni.
9. Zyra e censit, për çështje të veçanta mund të krijojë grupe pune, të cilat bëjnë vlerësime, vërejtje dhe rekomandime për çështje nën kompetencën e tyre, sipas detyrave të përcaktuara në këtë ligj.
10. Vendimet në zyrën e censit merren me shumicën e votave të anëtarëve dhe, në rast se ato janë të barabarta, vendos vota e kryetarit të zyrës së censit.
11. Vendimet e zyrës së censit nënshkruhen nga kryesuesi i mbledhjes dhe sekretari i ngarkuar nga kryetari i zyrës së censit. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

### **KREU III PROCEDURAT E CENSIT**

#### **Neni 19 Fushata informuese**

1. Qëllimet dhe procedurat e censit si dhe detyrimet juridike lidhur me të bëhen publike nëpërmjet mediave dhe një fushate të gjerë informimi, të drejtuar nga INSTAT-i.
2. Fushata informuese fillon, të paktën, 8 javë përpara ditës së censit dhe përfundon me nxjerrjen e rezultateve përfundimtare të tij.

## **Neni 20**

### **Personeli i censit**

#### 1. Personeli i censit përbëhet nga:

##### a) stafi i terrenit, që ka në përbërje:

- i. anketuesit, të cilët, të pajisur me një shenjë dalluese zyrtare, shkojnë në çdo banesë brenda territorit të caktuar të mbledhjes së të dhënave për të intervistuar banorët dhe për të plotësuar me saktësi pyetësonin e censit;
- ii. kontrollorët, të cilët kontrollojnë, mbështesin dhe raportojnë punën e disa anketuesve;
- iii. mbikëqyrësit, të cilët menaxhojnë, mbështesin dhe raportojnë punën e disa kontrollorëve;
- iv. specialistët IT, të cilët mbështesin stafin e terrenit për sigurimin dhe mirëmbajtjen e çdo pajisjeje kompjuterike të shpërndarë gjatë veprimtarisë në terren;
- v. specialistët GIS, të cilët mbështesin stafin e terrenit për gjeokodifikimin e të dhënave të mbledhura të censit nëpërmjet përdorimit të teknologjisë GIS.

##### b) stafi tjetër, ku përfshihen:

- i. trajnerët, të cilët trajnojnë stafin e terrenit për kryerjen e detyrave të tyre;
- ii. operatorët, të cilët hedhin të dhëna në sistemet e kompjuterizuara;
- iii. personeli drejtues, i cili duhet të organizojë dhe të drejtojë përgatitjen, njoftimin, logjistikën, veprimtarinë në terren dhe administrimin e censit;
- iv. statisticienët, demografët dhe personeli tjetër, të cilët përpunojnë të dhënat, analizojnë e raportojnë përmbledhëset dhe nxjerrin rezultatet statistikore të censit.

2. INSTAT-i përcakton kriteret dhe ngre një komision *ad-hoc* vlerësimi për përzgjedhjen dhe rekrutimin e personelit të censit.

### **Neni 21**

#### **Ndalimi për mbledhjen e të dhënave të ngjashme**

1. Gjatë një periudhe kohore prej 6 javësh, përpara ditës së censit, dhe gjatë periudhës së mbledhjes të të dhënave për censin është e ndaluar, për të gjithë individët dhe organizatat, të mbledhin të dhëna nga publiku brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2, të këtij neni.
2. Të gjithë individët apo organizatat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, të cilët, gjatë periudhës prej 6 javësh, para ditës së censit, dhe periudhës së mbledhjes të të dhënave, synojnë të grumbullojnë të dhëna për individë, njësi ekonomike familjare, banesa ose për veprimtari tregtare e private, duhet të kërkojnë një autorizim të veçantë pranë Komisionit Qendror të Censit.

### **KREU IV**

#### **KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE**

### **Neni 22**

#### **Kundërvajtjet**

1. Shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen, përkatësisht, si më poshtë vijon:
  - a) Refuzimi për të dhënë informacionin e kërkuar, sipas nenit 5, të këtij ligji, ose dhënia e informacionit të rremë, me gjobë, nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;  
Refuzimi për të dhënë informacion për pyetjet mbi bazën e vullnetit të individit, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij ligji, nuk përbën kundërvajtje administrative.
  - b) Mosrespektimi i rregullave të konfidencialitetit, të përcaktuara në nenin 9, të ligjit, nga personi/personat përgjegjës, me gjobë, nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
  - c) Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në nenin 21, të këtij ligji, nga personi/personat përgjegjës, me gjobë, nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Për hetimin administrativ të kundërvajtjeve të parashikuara në këtë nen INSTAT-i ka të drejtë të konsultojë bazat e të dhënave shtetërore në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 23**

#### **Vlerësimi i kundërvajtjeve administrative**

1. INSTAT-i është përgjegjës për shqyrtimin e çdo dokumenti që vërteton kundërvajtjen administrative, në përputhje me nenin 22, të këtij ligji, dhe për vendosjen dhe ekzekutimin e gjobave zbaton procedurat e ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.
2. INSTAT-i është përgjegjës për konstatimin e kundërvajtjes administrative, në përputhje me nenin 9, të këtij ligji, dhe e referon rastin pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

### **Neni 24**

#### **Ankimi ndaj sanksionit për kundërvajtjen administrative**

1. Ankimi ndaj një vendimi të INSTAT-it për vendosjen e një gjobe, sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 22, të këtij ligji, paraqitet në Komisionin Qendror të Censit, brenda 10 ditëve, nga data e shpalljes së këtij vendimi.
2. Kundër vendimit që ka marrë Komisioni Qendror i Censit, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të paraqitet ankim në gjykatë brenda 45 ditëve, nga data e shpalljes së këtij vendimi.

## **KREU V**

### **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 25**

Ligji nr.8669, datë 26.10.2000, “Për censusin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave”, i ndryshuar, shfuqizohet.

### **Neni 26**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

K R  
Y E  
T A

R I

GRAMOZ RUÇI

V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

P Ë R

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR CENSIN E POPULLSISË DHE  
TË BANESAVE”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për censin e popullsisë dhe të banesave”, për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

SENIDA MESI